

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Atentati në burgun e Vaqarrit/ Gjykata e Lartë rikthen në gjyq Ergys Kolaverin
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/15/atentati-ne-burgun-e-vaqarrit-gjykata-e-larte-rikthen-per-rigjykim-ceshtjen-e-ergys-kolaverit/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 15:37:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 15:32:58 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4ed457dab54a36cb47b38d58894ee7271b86f5eaf2940d4572440a50a414c1e9
TEKSTI	e91d3fa668392e5db0374cccc165c9261e972d6a3d278b5d89d031247b03efd2
PAMJA	5b99f1c4b23aa4795ff3036f8127242f6ff7bd706940d21d801d01b19f3eb731

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	546a3726e3a1969bd369aa90d8be0bc7947ae935645a881f3f4460ea4c5728c5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	732ea03e09e76f3f4c4f7148212f99ed57cacfcbea6b7c5016ac103a159e81ab
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/546a3726e3a1969bd369aa90d8be0bc7947ae935645a881f3f4460ea4c5728c5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Atentati në burgun e Vaqarrit/ Gjykata e Lartë rikthen në gjyq Ergys Kolaverin

17:32 : 15/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE



Gjykata e Lartë ka vendosur të prishë vendimin e pafajësisë ndaj **Ergys Kolaverit** dhe ta kthejë çështjen për rigjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Vendimi është shpallur sot, ndërsa trupa gjyqësore ka urdhëruar që çështja të shqyrtohet nga një tjetër trupë gjyqësore në të njëjtën gjykatë.

Më herët, Gjykata e Apelit kishte ndryshuar vendimin e Gjykatës për Krimet e Rënda të vitit 2016, e cila e kishte dënuar Kolaverin me 20 vite burgim. Bëhet fjalë për një çështje që lidhet me atentatin e vitit 2016, kur nga jashtë ambienteve të burgut të Vaqarrit u qëllua me armë zjarri në drejtim të të burgosurve.

Objektiv i sulmit dyshohet se ishte **Gazmir Daci**, për motive që lidhen me gjakmarrjen, ndërsa i plagosur mbeti L. Dulaj, i cili, sipas hetimeve, rezultoi të ishte objektiv i gabuar i atentatit.

Kolaveri ishte akuzuar nga ish-Prokuroria për Krimet e Rënda për veprat penale "Vrasje për gjakmarrje e mbetur në tentativë", "Plagosje e rëndë me dashje", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit" dhe "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta".

Lexo edhe:

[Gjykata e Lartë lë në burg Erion Vellaj](#)[Erion Vellaj kërkon lirimin nga burgu, Gjykata e Lartë shqyrton sot masën e sigurisë](#)

Sipas akuzës, atentati dyshohej se ishte kryer për motive gjakmarrjeje ndaj Gazmir Dacit, i cili ishte përfshirë më herët në vrasjen e Valmir Kolaverit dhe plagosjen e rëndë të vëllait të tij. Për këto ngjarje, Daci ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me 35 vite burgim.

Tashmë, pas vendimit të Gjykatës së Lartë, çështja e Ergys Kolaverit do të rikthehet për shqyrtim në Apel, por nga një tjetër trupë gjyqësore.

Si ndodhi atentati në burgun e Vaqarrit

TË GJITHA



Investim në arsim, gjithëpërfshirje dhe mundësi të barabarta

17:37 : 15/09/2026



Atentati në burgun e Vaqarrit/ Gjykata e Lartë rikthen në gjyq Ergys Kolaverin

17:32 : 15/09/2026



Kush fshihet pas kokainës në Portin e Durrësit, gjurmët që të çojnë te "Gjenerali"

17:22 : 15/09/2026



Komisioni i Ligjeve miraton ndryshimet ligjore për pagat e magistratëve

17:07 : 15/09/2026



Ebola në Kongo, rëndohet bilanci, OKB paralajmëron për muaj të vështirë

16:59 : 15/09/2026



"Diplomacia e dollarit" vjen në Shqipëri/ Si u hapën dyert për Kushnerin

16:49 : 15/09/2026



Aksidenti i rëndë në Dibër, plagosen 5 persona, 4 prej tyre nisen drejt Tiranës

16:47 : 15/09/2026

Atentati në burgun e vaqarrit ndodhi më 30 korrik 2010, rreth orës 10.30, gjatë kohës kur te paraburgosurit ndodheshin në ambientet e ajrimit. Nga jashtë mureve të burgut u qëllua me armë zjarri në drejtim të Gazmir Dacit, i cili ndodhej në paraburgim për vrasjen e Valmir Kolaverit dhe plagosjen e rëndë të vëllait të tij, Robertit.

Sipas hetimeve të asaj kohe, objektivi i atentatit ishte Daci, ndërsa plumbi goditi në këmbë të paraburgosurin Lili Dulaj, i cili nuk ishte shënjestra e sulmit. Autoritetet dyshuan se të shtënat ishin kryer nga një distancë e konsiderueshme jashtë perimetrit të burgut, me një armë snajper.

Për ngjarjen u arrestuan Ergys Kolaveri dhe kushëriri i tij Enea Ceka. Sipas akuzës, atentati dyshohej se ishte motivuar nga hakmarrja, pasi Gazmir Daci ishte akuzuar për vrasjen e Valmir Kolaverit dhe plagosjen e Robert Kolaverit në nëntor 2015.

Në vitin 2017, Gjykata për Krimet e Rënda e dënoi Ergys Kolaverin me 20 vite burg për atentatin, ndërsa më pas çështja kaloi në disa shkallë gjykimi. Në vitin 2022, Gjykata e Apelit e shpalli atë të pafajshëm, vendim që tashmë është prishur nga Gjykata e Lartë, e cila ka urdhëruar rigjykimin e çështjes.

Etiketa: [atentat](#) [ergys kolaveri](#) [Gjykata e larte](#) [vaqarr](#)

Lajme të lidhura



Gjykata e Lartë lë në burg Erion Veliajn

11:09 : 15/09/2026



Erion Veliaj kërkon lirimin nga burgu, Gjykata e Lartë shqyrton sot masën e sigurisë

08:59 : 15/09/2026



Seanca në Gjykatën e Lartë/ Nuk gjykohet kryebashkiaku, por individi Erion Veliaj, i akuzuar për korrupsion

21:12 : 14/09/2026



Veliaj dhe "çunat e Vajzës", Rama-Sadushi!

16:13 : 13/09/2026



Nga kandidati për KLGJ, tek "shpëtimtari" i Geron Xhafaj, tre gjyqtarët që kanë në dorë fatin e Erion Veliaj

12:51 : 13/09/2026



Larje hesapesh nga Italia? Akil Lleshi objektivi i atentatit në Mat, dyshohet për dy autorë

12:15 : 13/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

